



SHP Kumanovë

## Miratoohen dokumente të rëndësishme për punë

Në rendin ditor të seancës të Kuvendit të SHP Kumanovë, e mbajtur në mesin e marsit të viti 2017, në qendër të vëmendjes së anëtarëve ishin ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të shoqatës, Llogaria vjetore, Fondi i solidaritetit për vitin 2016 si dhe Projekti "Në vizitë me qëllim të mirë". Në sjelljen e Statutit u parapri një debat i gjerë, duke filluar nga Këshilli për statut dhe çështje juridike, më pas në degët e pensionistëve dhe Bordit ekzekutiv.

Në mbledhjet e pen-



sionistëve u paraqitën mbi 50 propozime për përmirësimin e dispozitave të caktuara, - u tha në shpënjimin e kryetarit të Shoqatës, Spirko Nikolovskii.

Për deakumulimin e funksioneve drejtuese u përcaktua funksion i veçantë Kryetar i Kuvendit. Më ndryshimet parashihet numri i degëve të ulët në 25, Kuvendi të

numëron 51 anëtarë, Bordi ekzekutiv 11 anëtarë, bordet dhe komisionet nga 3. Këto ndryshime do të kontribuojnë për punë më ekonomike dhe racionale. Vëmendje e veçantë iu

kushtua Llogarisë vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në vitin 2016. Pas sqarimit të Snezhana Andova, kryetare e Këshillit mbikëqyrës, u vë

në dukje se dy të tretat nga të ardhurat e realizuara të përgjithshme janë shfrytëzuar për nevojat më funksionale të pensionistëve.

Kuvendi e pranoi dhe propozimin e Komisionit për shëndetësi dhe çështje sociale, të ketë qasje për kujdes më të madh për pensionistët e moshuar të sëmurë dhe të paafët me realizimin e Projektit "Në vizitë me qëllim të mirë", për çka sqarim tha kryetari i Komisionit Nikolla Kostovski. Bartës kryesor do të jenë degët e pensionistëve.

70 vjetori i organizimit të pensionistëve në Maqedoni

# Doli nga shtypi Monografia "Aktivitetet e pensionistëve për respekt"

Me rastin e daljes të Monografisë "Aktivitetet e pensionistëve për respekt" kryeredaktori dhe një nga autorët Dragi Argirovski, me pak fjalë e përshkruan rrugën që ka ardhur për krijimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, punë e cila do të lë gjurmë të përherëshme në historinë e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë për aktivitetet e pensionistëve dhe arritjet në shtatë vitet e kaluara.

Krijimi i kësaj vepre është rezultat i dëshirës dhe vendimit të të gjithë organeve dhe trupave të LSH-PM, nga Komiteti organizativ për shënimin e jubileut të madh, 70 vite organizim i pensionistëve të Maqedonisë, përmes Këshillit ekzekutiv dhe Kuvendit.

Për realizimin e Monografisë është dhënë kontribut i madh. Monografia ka 200 faqe dhe mbi 470 fotografi, shumë dokumente, faksimile etj. Janë shfrytëzuar revista zyrtare, 21 buletin për garat rajonale dhe republikane sportive për pensionistët, 14 buletin për shfaqje rajonale dhe republikane për këngë, muzikë dhe lojëra, 103 gazeta "Pensionist plus", 60 kopje "Horizontet e pensionistëve" në gazetën "Nova Makedonija", faqe në gazetën në gjuhën shqipe "KOHA" dhe gaze-



ta të tjera, dokumente, shtesa dhe dosje, informator dhe materiale arkivore. Puna ishte lodhshme, me shumë hulumtime dhe komplekse.

Ajo u konstatua dhe në seancën e zgjeruar të Këshillit botues të Monografisë dhe në formë elektronike janë prezantuar trajnime kompjuterike të monografisë së plotë, me koment në përmbajtjen në të gjithë 10 pjesët. Pas përfundimit të prezantimit kishte diskutim ku u kyçën të gjithë të anëtarët e pran-

ishëm të Këshillit botues: Besnik Pocesta, Saltir Karovski, Ilija Adamoski, Dushan Ristoski, Spirko Nikolovski, Gorgje Andonov, Vele Aleksoski, Baki Bakiu. Nga diskutimet, konkluzioni i përgjithshëm ishte se Monografia është e punuar shkëlqyeshëm dhe se përfshin një numër të madh të të dhënave.

Të gjithë diskutuesit kishin vetëm fjalë lavdërimi për përmbajtjen, për formën artistike dhe dizajnin. Diskutimi u mbyll me proverbin: fjalët fluturojnë, vetëm shkrimi mbetet, që është një e vërtetë e madhe dhe e saktë! U soll vendim të shtypen 300 kopje në gjuhën maqedonase, për çka janë siguruar mjetë nga sponsorë për këtë qëllim. Është planifikuar shtypja dhe e rreth 100 kopje në gjuhën shqipe, për çka janë realizuar bisedime me Fondacionin "Albiz" në Shkup dhe priten rezultate pozitive, thotë Argirovski.

Recensues i monografisë është Aleksander Dimkovski, kryeredaktor i gazetës "Nova Makedonija", e cila për më shumë se një dekadë bashkëpunon me LSHPM përmes publikimit të shtesës mujore "Horizontet e pensionistëve", por dhe duke i ndjekur me profesionalizëm aktivitetet e LSHRM.

SHP Çair

## Vizitë në Kratovë dhe në Manastirin e Lesnovës



Në kuadër të programit për vitin 2017, ndërsa me planin mirë të përgatitur që përpara, më shumë se njëqind pensionistë të SHP Çair, shoqatë me përbërje multietnike, më 12 prill kanë qenë në ekskursion në vizitë të kompleksit të Manastirit Shën Gavril Lesnovski, që gjendet në rrëzën jugperëndimore të malit të Osogovës, pesëmbëdhjetë kilometra larg Probishtipit, në fshatin Lesnovë. Në kuadër të kompleksit gjendet dhe tempulli Shën Arhangell Mihail, i cili posedon vlera të jashtëzakonshme ikonografike, i cili mahnitë me ndërtimin e vet monumental dhe ikonostasit e bërë në gdhendje nga gdhendësit miak. Pas Lesnovës, destinacioni tjetër ishte Kratova, ku janë vizituar çarshia dhe disa shtëpi të vjetra me ndërtime autentike, saraj shtëpia dhe tunelet nëntokësore dhe të tjera. Pensionistët posaçërisht

janë interesuar dhe kanë vizituar Urën e njohur të Radit, e cila këndohet në shumë këngë.

"Ky ekskursion është i pari gjatë këtij viti dhe paraqet pjesë të programit. Interesimi është i madh i pensionistëve tanë për ekskursionet të këtylla njëditore me karakter mësimor. Pastaj mbajmë llogari që numri sa më i madh i pensionistëve të marrin pjesë në ekskursionet të këtylla edhe atë nga të gjitha degët. Edhe për këtë ekskursion, sikurse për shumë të tjera, shpenzimet i kryen shoqata. Nuk ndalemi këtu. Do të vizitojmë edhe disa vende të rëndësishme historike dhe kulturore", ka thënë kryetari i KE të SHP Çair, Mentor Oku. Shumica e pensionistëve për herë të parë kanë vizituar këtë kompleks të manastirit dhe qytetin e Kratovës dhe kanë qenë të mahnitur nga ajo që kanë parë. (V. P.)

SHP Dibër Qendra Zhupë

## Shembull i bashkëjetesës dhe tolerancës

Gjatë vitit të kaluar SHP Dibër dhe Qendra Zhupë kishte aktivitetet të shumta në interes të anëtarëve të saj. Shoqata ishte pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet lokale, rajonale dhe takime republikane të pensionistëve dhe ka pasur sukses shumë të mirë. Nëpërmjet aktiviteteve të shumta të kësaj shoqate me mbi 2 mijë anëtarë në Komunën e Dibrës dhe Qendra Zhupë, kontribuon në re-

alizimin e nevojave të pensionistëve dhe përmirësimin e shëndetit dhe jetës së tyre. Kjo, përveç asaj, u theksua në raportin për punë në vitin 2016, për çka u diskutua në seancën e fundit të Kuvendit të SHP Dibër dhe Qendra Zhupë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i shoqatës, Xhavit Karpuzi, theksoi se shoqata vitin e kaluar ka shënuar sukses të madh në të gjitha lëmit. Sipas tij



anëtarët e shoqatës janë shumë të kënaqur nga aktivitetet të cilat janë në in-

teres të tyre.

Në fjalën e tij përshëndetëse kryetari i Kuvendit

të LSHPM, Besnik Pocesta tha se SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, është një nga më atraktivet në vend dhe potencoi se në këtë shoqatë, veçanërisht kultivohet bashkëjetesa dhe toleranca e ndërsjellë, që mund të shërbejë si shembull për shoqatat të tjera. Duke pasur parasysh se pensionistët nga dy komunitet të ndryshme etnike dhe nga shumë religjione, dokumentacioni dhe ar-

tikujt janë në gjuhët e folura. Dokumentet kryesore të cilat janë miratuar në seancën e shoqatës janë në gjuhën maqedonase dhe shqip dhe ajo nuk krijon probleme. Kuvendi njëzëshëm e miratoi Raportin për punë në vitin 2016 dhe Programin për punë në vitin 2017, ku theksohet se Shoqata do të vazhdojë me aktivitetet e planifikuara dhe projektet të cilat janë në interes të shoqërisë. (V.S.)